

# Debat i hapur publik në lidhje me Propozim-udhëzimin për mbikëqyrjen e realizimit të konceptit programor

**Shkup, 23.04.2018.** – Mbikëqyrja e jashtëzakonshme për respektimin e nenit 67 paragrafi 6 nga LSHMAA, i cili përcakton se radiodifuzerët janë të obliguar që gjatë një viti të plotësojnë 80% të konceptit programor për të cilin edhe jepet leja për emetim të radios dhe televizionit, tregoi se është e domosdoshme që në një dokument të posaçëm të konstatohet mënyra e veprimit të Agjencisë gjatë mbikëqyrjes së kësaj dispozite. Njëherë, nevojitet që të sqarohet se si do të llogaritet nëse radiodifuzeri gjatë një jave plotëson 80% të konceptit programor.

Agjencia përpiloi **Propozim-udhëzimin për mbikëqyrjen e zbatimit të konceptit programor** dhe i fton të gjitha palët e interesuara që të marrin pjesë në debatin publik për këtë dokument. Mendimet dhe propozimet në formë të shkruar mund të dorëzohen në formë elektronike në **contact@avmu.mk**.

Debati publik është i hapur deri më datë **30 prill 2018 (e hënë)**.